



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
OPSTINA SUVA REKA / MUNICIPALITY OF SUHAREKE
ZYRA E PROKURIMIT
PROCUREMENT OFFICE

Nr: 004 /2022

Nr. Protokolli: 08/2022

Date: 25.02.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës **23.02.2021**, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **Arianit R. Bytyqi, Rruga Bardhyl Çausi, Obj.E. Nr.7, 10000, PRISHTINË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje teknologjike (kompjutera ,llaptop,videoprojektora)dhe pajisje tjera –Projektora** me Nr. të Prokurimi: **624-21-8923-1-2-1 & 624-021-157-121-nxjerr** këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **23.02.2021**, e parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **Arianit R. Bytyqi, Rruga Bardhyl Çausi, Obj.E. Nr.7, 10000, PRISHTINË** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje teknologjike (kompjutera , llaptop, videoprojektora) dhe pajisje tjera –Projektora** kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës **18.02.2002** të publikuar në platformen elektronike.
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK** të publikuar me datë: **18.02.2002**.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 23.02.2022 , ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Furnizim me paisje teknologjike (kompjuterë , llaptop, videoprojektora) dhe paisje tjera-Projektora** me Nr. të Prokurimi: 624-21-8923-1-2-1 & 624-021-157-121, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës, 18.02.2022 të publikuar në platformën elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën tuaj, vlerëson se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë sepse:

-OE I propozuar ka përmbushur kërkesat e FDT-së ashtu siq është kërkuar dhe punësimi i stafit të OE është qështje e tyre se si e kanë rregulluar me kontrata në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Sa i përket pretendimit tjetër për qështjen e nënshkrimeve në mes të punësuarve dhe punëdhënësit, nuk është në kompetencën e AK të vlerësojë këtë pretendim, nëse ju keni dëshmi të duhura për këtë, ju inkurajojmë të vazhdoni me këto pretendime në institucionet përkatëse.

-Për pretendimin tjetër lidhur me ofrimin e dëshmimeve në kundërshtim me LPP-në, të OE të cilin e kemi eliminuar, ne tashme kemi marr masa konform nenit 99 të LPP-së, ashtu siq e kemi cekur në vendimin e datës 18.02.2022, pra për këtë OE kemi dorëzuar një kërkesë në OSHP dhe jemi në process të konfiskimit të sigurimit të tenderit.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shef i Zyrës së Prokurimit
Bujar Kuçi

